

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Për kompaninë : “ART MINERALS” LLC
Titulli i Projektit : Shfrytëzim dhe seperim i rërës kuarcore
Ngastra kadastrale : P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-01949-0
Zona Kadastrale : Pjetërshan
Komuna : Gjakovë
Aplikuesi i Projektit: z. Ilir Dedaj

Gusht 2025

Aplikuesi:

"ART MINERALS" LLC

Adresa: Rruga Nënë Tereza pn

Komuna Gjakovë

z. Ilir Dedaj

Tel: +383 48 104 797

E-mail: artkonstruktion.2@gmail.com

Hartuesi i raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

Eksperte e licencuar për VNM

Nr. Licencës së lëshuar nga MMPH:

70/17

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: edonak88@hotmail.com

Investitori:

"ART MINERALS" LLC

Hartuesi i Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

v.v

v.v

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së.....	5
2.1. Rregullativa Ligjore.....	5
2.2. Metodologjia e Punës.....	7
3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	8
3.1. Potencialet ekzistuese	8
3.7. Hidrogjeologjia	14
3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit	15
3.9. Natyra dhe biodiversiteti	19
3.10. Flora dhe Fauna	20
3.11. Dukshmëria	20
3.12. Ajri	21
3.13. Uji	21
3.14. Zhurma	21
3.15. Efektet vizuale (peizazhi)	21
4. 0. Procesi teknologjik i shfrytëzimit të rërës kuarcore	22
4.1. Përshkrimi i përgjithshëm.....	22
4.2. Parametrat e karrierës.....	22
4.3. Procesi i shfrytëzimit.....	22
4.4. Procesi i përpunimit teknologjik (seperimi dhe larja)	22
4.5. Faza të procesit teknologjik:.....	23
4.5. Sistemi i pastrimit dhe reciklimit të ujit.....	23
4.6. Mekanizimi dhe infrastruktura ndihmëse	23
4.7. Karakteristikat e procesit teknologjik.....	24
4.8. Masat e sigurisë teknike dhe ambientale	24
5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	24
5.1 Ndikimet në ajër	24
5.3. Ndikimet në ujë.....	27
5.4. Ndikimi në Peizazh	27
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	27
5.7. Zhurma	28
5.8. Ndikimet në raste aksidenteve mjedisore	29
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës	30
6.3. Masat për mbrojtjen e ujit	31
6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma	32
6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore	33
6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale.....	33
7. Monitorimi.....	33
9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT	35
11.0 PËRFUNDIM	38
12. LITERATURA	39
Shtojcë.....	39

1. HYRJE

Në kuadër të funksionimit të aktivitetit mineral, përkatësisht mihjes sipërfaqësore për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore, si dhe aktiviteteve të tjera përkatëse në kuadër të kompanisë “Art Minerals” LLC, është paraparë hartimi i raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), me qëllim të pajisjes me Pëlqim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Ky raport përfshin analiza të ndikimeve të mundshme në mjedisin përreth, duke përfshirë edhe botën e gjallë, për lokacionin ku planifikohet të bëhet shfrytëzimi i rërës kuarcore. Lokacioni ndodhet në zonën kadastrale Pjetërshan, në parcelat me numër P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-01949-0, me sipërfaqe përkatësisht 35,010 m² dhe 19,390 m². Të dy parcelat janë të kategorizuara si tokë pyjore – mal i klasës IV dhe V, në zonë rurale dhe në pronësi private.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument i domosdoshëm për pajisjen e kompanisë me Pëlqim Mjedisor dhe për marrjen e Lejes Mjedisore, si dhe licencave të tjera përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i hartimit të raportit është identifikimi dhe evidentimi i të gjitha kushteve ekzistuese në lokacionin ku planifikohen investimet dhe zhvillimi i aktiviteteve, duke pasur parasysh ndërhyrjet e vazhdueshme në mjedisin natyror që rrezikojnë ekuilibrin ekologjik. Në këtë kontekst, raporti synon të përcaktojë ndikimet potenciale të aktivitetit mineral dhe të propozojë masa mbrojtëse për parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis.

Raporti gjithashtu ka për qëllim të ndërgjegjësojë shoqërinë për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, përmes trajtimit të mbetjeve, kontrollit të zhurmës dhe reduktimit të pluhurit të dëmshëm që gjenerohet gjatë zhvillimit të aktiviteteve minerare.

Në mënyrë transparente, raporti paraqet ndikimet në mjedis që dalin nga shfrytëzimi i rërës kuarcore dhe veprimtaritë e tjera minerare, me qëllim të ruajtjes së cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjes së resurseve natyrore.

Ky vlerësim është hartuar për kompaninë “Art Minerals” LLC, me seli në Gjakovë dhe pronar z. Ilir Dedaj, duke u bazuar në projektin e hulumtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe dokumentacionin përkatës.

Detyra kryesore e këtij raporti është identifikimi i burimeve të ndotjes, vlerësimi i ndikimeve të tyre dhe ofrimi i masave për parandalimin ose zvogëlimin e tyre deri në kufijtë e lejuar nga ligji.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet e dala nga ky raport duhet të merren parasysh gjatë fazës së funksionimit dhe pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit të rërës kuarcore.

2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-së) është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit të vazhdueshëm të aktivitetit të shfrytëzimit të rërës kuarcore:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa Ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë „Art Minerals” LLC e cila planifikon të bëjë shfrytëzimin e rërës kuarcore janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025

- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet
- Ligji Nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
- Udhëzimi Administrativ (qrk) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.
- Udhëzim administrative MMPH Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrative Nr. 05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti i hulumtimit
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikatat mbi të drejtat e pronës

- Kopjet e planit të ngastrave
- Plani i situacionit
- Pëlqimin/njoftimi komunal

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar dhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse siç është direktiva e VNM-së.

2.2. Metodologjia e Punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për projektin e shfrytëzimit të rërës kuarcore, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore, që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike,
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacion,
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar,

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku planifikon të realizohet projekti i shfrytëzimit të rërës kuarcore.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të

bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore të mjedisit në të cilin do të zhvillohet aktiviteti i caktuar. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të projektit për shfrytëzimit të rërës kuarcore me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esence kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.1.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1 është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të projektit të shfrytëzimit të rërës kuracore në zonën kadastrale Pjetërshan komuna e Gjakovës.

3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit

Investitori për realizimin e këtij projekti do të pajiset me të gjitha miratimet përkatës të lejeve të nevojshme për lejimin e projektit të shfrytëzimit të rërës kuracore. Pronësia e truallit për realizimin e këtij projekti është pronë private e Ilir Dedaj nga Gjakova njëherit edhe pronar i kompanisë „Art Minerals” LLC.

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit

Qyteti i Gjakovës shtrihet ndërmjet koordinatave gjeografike 42.22° të gjerësisë veriore dhe 20.26° të gjatësisë lindore, në bregun e majtë të lumit Erenik, në lindje të pllajës së Çabratit dhe përgjatë të dy brigjeve të lumit Krena, në një lartësi mesatare mbidetare prej 365 metrash.


Lokacioni ku planifikohet të realizohet projekti për shfrytëzimin e rërës kuracore ndodhet në pjesën juglindore të territorit të Komunës së Gjakovës, në zonën kadastrale të fshatit Pjetërshan. Ky lokacion përfshin parcelat me numër P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-01949-0, me sipërfaqe përkatësisht prej 35,010 m² dhe 19,390 m². Parcelat janë të kategorizuara si tokë pyjore – mal i klasës IV dhe V, të cilat ndodhen në një zonë rurale dhe janë në pronësi private, sipas dokumentacionit kadastral përkatës, të bashkëngjitur këtij raporti.




Terreni i paraparë për shfrytëzim është i tipit kodrinoro-malore dhe karakterizohet nga pjerrësi mesatare deri e theksuar. Në afërsi të lokacionit ndodhet një tjetër sipërfaqe e mihur për qëllime të ngjashme të shfrytëzimit të rërës kuarcore. Parcelat përreth janë të mbuluara me pyje natyrore, kryesisht me drunj të llojeve hermoq, qarr dhe bung, ndërsa më tej në distancë gjenden edhe toka bujqësore të kultivuara.

Në pjesën veriore, parcelat kufizohen me prona të cilat kanë qasje direkte në një rrugë dytësore, e cila lidhet me rrugën kryesore që shpie në fshatin Pjetërshan dhe më tej në fshatrat përreth. Lokacioni ndodhet rreth 430 metra larg zonave të banuara dhe më shumë se 6.5 kilometra nga qendra e qytetit të Gjakovës.

Sa i përket kufijve administrativë, lokacioni kufizohet në verilindje me fshatin Kushavec, në lindje me fshatrat Smaq dhe Blinishtë, ndërsa në perëndim dhe jug me prona shoqërore. Lartësia mbidetare në këtë zonë varion nga 440 metra deri në 500 metra.

Në bazë të rezervave të konstatuara të rërës kuarcore dhe pozitës së favorshme gjeografike, mund të thuhet se ekzistojnë kushte të mira për shfrytëzimin e këtij resursi natyror. Për më tepër, aktualisht në afërsi të lokacionit nuk ka objekte apo aktivitete të tjera industriale që lidhen me shfrytëzimin e gurit gëlqeror apo të rërës kuarcore, siç vërtetohet edhe nga pamjet satelitore të bashkangjitura me këtë raport.








Foto 1. Pamje satelitore e lokacionit ku planifikohet të bëhet zgjerimi i sipërfaqës së eksploatimit. Në kohën kur është hartuar Raporti për vlerësimin e Ndikimit në mjedis, për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor nga ana e MMPHI kompania nuk ka filluar asnjë aktivitet të pastrimit apo përgatitjes së sipërfaqes për mihje dhe eksploatim.

3.4. Popullsia dhe vendbanimet

Kur është në pyetje procesi i VNM-së, ndër veçoritë kryesore janë edhe popullata, zhvillimet demografike si dhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve të ndryshme janë, ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Popullsia e Gjakovës që nga fillimi në masë të madhe ishte shqiptare pasardhës të ilirëve, ndërsa një pakicë ishte serbe e, më vonë, pas kolonizimit, edhe malazeze. Për kah feja shumica dërmuese ishin myslimanë e katolikë (shqiptarët), ndërsa pakica ortodoksë (serbët e malazezët).

Në mungesë të të dhënave të sakta statistikore për numrin e popullsisë së qytetit dhe të rrethinës deri në gjysmën e dytë të shek. XIX, do të përmendim të dhënat e udhëpërshkrueseve të ndryshëm, sipas të cilave qyteti në shek. XVII i kishte 2000 shtëpi, ndërsa më 1838 i kishte 1900 shtëpi me 21.000 banorë. Më 1857 Gilferdingu e quante Gjakovën qytet shqiptar me 3500 shtëpi shqiptare myslimane, me 70 katolike dhe me 60 shtëpi serbe. Më 1879 qyteti me rrethinë i kishte 15.210 banorë, 12.553 myslimanë dhe 2.757 të krishterë. Më 1900 sipas Millojeviqit Gjakova kishte 4000 shtëpi myslimane dhe mbi 70 serbe.

Në qytetin e Gjakovës me rrethinë, që përfshinte 708 km², më 1921 jetonin 32.847 banorë (30.798 shqiptarë myslimanë e katolikë dhe 2.049 serbë e malazezë ortodoksë); më 1931 jetonin 45.376 banorë (38.982 shqiptarë myslimanë e katolikë dhe 6.394 serbë e malazezë ortodoksë) që do të thotë se më 1921 ishin 93,76 përqind shqiptarë, kurse 6,24 përqind serbë, ndërsa më 1931 85,91 përqind ishin shqiptarë, ndërsa 14,09 përqind ishin serbë e malazezë.

Bazuar ne rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës në vitin 2011, numri i përgjithshëm i banorëve të komunës së Gjakovës është 94,556 banorë, dhe atë sipas kësaj strukture etnike: Shqiptarë: 87,672 banorë; Egjiptian: 5,117; Rome: 738; Ashkali: 613; Boshnjak: 73; Serb: 17; Turqi: 16; Goran: 13; Te tjerë: 92;

Lokacioni i planifikuar për eksploatim të rërës kuarcore ndodhet në bjeshkën e bjeshkën e Kusarit në zonën kadastrale Pjetërshan komuna e Gjakovës, në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit nuk është konstatuar ndonjë objekt banimi përkatësisht vendbanim i populluar, ato ndodhën në distancë rreth 430 metra larg. Kjo zonë kryesisht konsiderohet të jetë bjeshkë dhe zonë malore. Në afërsi të parcelës rreth 1600 metra ndodhet Shpella e Kusarit.

3.5. Lidhjet e Komunikacionit

Komuna e Gjakovës disponon një infrastrukturë rrugore të ndërtuar për rreth 90%. Ajo kufizohet me 11 fshatra ndërkufitare me Shqipërinë dhe ka akses të shpejtë përmes tre pikave kufitare me Shqipërinë. Lidhja më e afërt e Gjakovës me autostradën Prishtinë-Tiranë është në Prizren, distanca e së cilës është rreth 30 km me automjet. Megjithatë, Gjakova nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me sistemin hekurudhor. Rruga magjistrale M9-1 kalon përmes Gjakovës për të shkuar në Shqipëri. Lokacioni ku ndodhet kompania „Art Minerals “ LLC lidhet përmes rrugës së fshatit Pjetërshan rrugë e cila të dërgon në bjeshkën e Kusarit. Kjo lidhje e mirë e komunikacionit rrugor i mundëson kompanisë të ketë vlerën ekonomike për tregun vendor por edhe atë ndërkombëtar. Ndërsa furnizimi me energji elektrike do të bëhet përmes rrjetit elektrik të zonës dhe trafos private.

3.6. Kushtet klimatike

Lokacioni i planifikuar të bëhet shfrytëzimi i rërës kuarcore që konsiderohet si pjesë e jug-përendimit të Kosovës ka klimë të lagësht kontinentale me ndikim mesdhetar dhe oqeanik, që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë me borë. Ajo ndikohet nga masat ajrore kontinentale, me dimra më të ftohtë dhe vera të nxehta.

Malet e ulëta me qafa siç janë Qafa e Prushit, ajo e Dobrunës, ajo e Morinës etj., kanë mundësuar ndikimin e erërave të Detit Adriatik nëpër luginën e Drinit. Prandaj Gjakova me rrethinë ka klimë të mesme kontinentale me elemente të asaj mesdhetare me verë të nxehtë dhe të thatë.

Temperatura mesatare e muajit korrik është 21,5 C, ndërsa e janarit -09 C. Muajt e verës janë të thatë, ndërsa të dimrit me lagështi. Mesatarja e reshjeve atmosferike është 959,3 mm.

3.7. Hidrogeologjia

Lumenjtë dhe rrjedhat e ujrave në Gjakovë përfshihen në pellgun ujqor të lumit Drini i Bardhë, i cili formon kufijtë e komunës me komunën e Rahovecit në lindje. Lumi Ereniku buron nga Bjeshkët e Nemuna dhe rrjedh përmes territorit të komunës, për t'i bashkuar në fund me lumin Drini i Bardhë. Lumenjtë dhe përrenjtë më të vegjël, si Neci, Trava dhe Trakaniqi Raça, rrjedhin nga veriu në jug dhe shpërndahen në lumin Ereniku. Sot, shtrati dhe brigjet e këtyre lumenjeve janë në degradim të vazhdueshëm për shkak të shfrytëzimit të pa-kontrolluar të rërës dhe zhavorrit. Lumi Krena kalon nëpër qytet dhe shtrati i tij është rregulluar pjesërisht në një gjatësi prej 1400 metrash. Gjendja e lumit ka qenë e degraduar, por punimet që janë bërë nga komuna gjatë vitit 2021 është rregulluar vetëm një pjesë e rrjedhjes së lumit përgjatë qendres së qytetit, Lumi Trakaniq kalon në pjesën lindore të qytetit dhe shtrati i tij nuk është i rregulluar ende. Gjendja e tij është jo e favorshme, jo vetëm për shkak të shkatërrimeve të ndryshme, por edhe për shkak të hedhjes së mbeturinave në shtrat dhe përgjatë tij. Një tjetër burim ujqor në Komunën e Gjakovës është Liqeni i Radoniqit - i cili ka filluar të mbushet në vitin 1982 nga ish lumi Radoniq dhe Lumbardhi i Deçanit përmes një kanali derivues me ngritjen e Pendës që gjendet në Llukë të Epërme. Ky liqen është në funksion që nga viti 1985 dhe ka kapaciteti maksimal rreth 117 milion m³ deri në

kuotën mbidetare 456m. Në territorin e komunës, një pjesë e madhe e sipërfaqes së nëntokës së burimeve ujore ka ndjeshmëri mesatare prej 23,027.09 ha apo 39.30 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 14,532.63 ha apo 24.80 % e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore. Në zonën ku planifikohet të shfrytëzohet rëra kuarcore nuk ka në afërsi ndonjë burim apo rrjedhje ujore.

3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit

Rajoni i studiuar i takon zonës kadastrale Pjetershan. Vendburimi përbëhet nga shkëmbinj ndërtimorë të kretakut të sipërm, me sedimente të flishit, gurë gëlqerorë mergelorë dhe gurë ranorë, të mbuluar nga formacione humusi, të cilat gjithashtu përmbajnë sasi të vogla rëre dhe zhavorri.

Rajoni ka kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim ekonomik. Trashësia e serisë së produkteve të këtyre shkëmbinjve në këtë vendburim arrin mbi 40 m, ndërsa mbulesa varion nga 0,30 m deri në 0,50 m.

Karakteristikat litostratigrafike

Në ndërtimin gjeologjik të lokalitetit Z.K. Pjetershan, Gjakovë, marrin pjesë shkëmbinjtë ndërtimorë të formimit të periudhës së Shkumësit, gabro-diabazet, zhavorret, argjila dhe rërat, por kryesisht dominojnë argjilat dhe rëra kuarcore.

Rajoni i gjerë i vendburimit përbëhet nga këto njësi litologjike:

- Produktet e Triasikut (T)
- Produktet e Kretakut (K)
- Depozitimet e Neogjenit (Ng)
- Produktet e Kuaternarit (Q)

Produktet e Triasikut (T)- Krijimet e triasikut janë zhvilluar në një hapësirë të gjerë në pjesët perëndimore dhe veriore të Rrafshit të Dukagjinit gjegjësisht në rajonin e Bjeshkëve të Nemuna, e me siguri sipas të gjitha gjasave vazhdojnë edhe nën krijimet e neogjenit të Rrafshit të Dukagjinit. Këto krijime janë shkëmbinjë kompleks dhe të ndërlikuar të përfaqësuar nga ranoret, brekçet, konglomeratet dhe rreshpeve kristalore. Në këtë pjesë do të japim karakteristikat e formacioneve gjeologjike që e ndërton zonën e gjerë të vendburimit “Pjetërshan” – Gjakovë gjegjësisht zonën e shtrirjes në rrjetin parësorë hidrografie të ujërave që mbledh kjo rrjedhë.

Triasku i Poshtëm-Mesëm është i përhapur në vendbanimin Batushë (jug) dhe në Malet e Junikut, Vokshit dhe Strellcit (veri). Përfaqësohet nga seria vullkanogjeno-sedimentare, gëlqerorë, dolomite, serpentinite, diabaze, granite dhe kuarcporfire.

Triasku i poshtëm (T 1)- Është konstatuar në veri të rajonit në pjesën e sipërme të Grykës së Rugovës dhe vazhdon me shtrirje duke mbuluar anën veriore të vendburimit. Përfaqësohet nga ranorët argjilor, argjilat ranore karbonitike dhe gëlqeroret të mermerizuar dhe rreshpezuar. Seria e triaskut të poshtëm më së miri është zhvilluar në majën e Nenxhinatit. Në këtë pjesë krijimet e paleozoikut (me filite, ranorët e rreshpzuar, thjerrëzat gëlqerore të mermerizuar dhe dolomitët, diabazët etj) janë të vendosura nga poshtë lartë sedimentet e triaskut të poshtëm me këtë renditje: gëlqeroret pllakor të mermerizuar me ngjyrë të zezë, gëlqeroret të mermerizuar me ngjyrë të zezë dhe të bardhë brekqioze.

Triasku i mesëm (T2)- Shtrihet në veri të rajonit të Rugovës në majën e Nexhinatit, fushën e thartë dhe majën e Strellcit. Përfaqësohet nga formacionet e gëlqerorëve të katit anizian, sedimentëve vullkanogjene dhe shtresave masive të gëlqerorëve dhe dolomitëve. Shtrirja e triaskut të mesëm është baza ku shtrihet vendburimi, që donë të thotë se këto krijime vazhdojnë në drejtim veri – lindor të Bjeshkëve të Nemuna.

Triasku i sipërm (T3)- Përfshin hapësirë të vogël të shtrirjes me triaskun e mesëm. Shtrihet në bjeshkën e Lumëbardhit dhe në hyrje të Grykës së Rugovës, përfaqësohet nga gëlqerorët masiv dhe dolomitët. Të gjitha këto shtrirje të krijimeve gjeologjike janë dhënë në hartën gjeologjike 1 : 100.000.

Produktet e Kretakut (K) - Ana lindore e vendburimit është e ndërtuar nga harcburgitet e serpentizuar të masivit ultrabazik të Rahovecit (δ), brekçet gëlqerore dhe gëlqerorët koralor të Kretës së poshtëm (K1), kllastitet dhe gëlqerorët me alge e rudistet të Kretës së sipërme (K21), gëlqerorët pllakos, argjilor dhe thjerrëza të stralleve të Kretës së sipërm (2-4K23), sedimentet e Pliocenit të mesëm dhe të sipërm (Pl2,3) dhe sedimentet e Kuarternarit – Q (suargjilat, zhavorret dhe surrat diluviale dhe “shtroja” e çakallit).

Harcburgitet e serpentizuar (δ) paraqesin anët jugore të masivit ultrabazik të Rahovecit. Përfaqësohen nga Harcburgitet e serpentizuar dhe serpentinitet harcburgite si dhe në masat e dunitëve të cilat së bashku paraqesin masën themelore

në të cilën janë futur të gjitha varietetet tjera të kompleksit ultrabazik. Këta shkëmbinjë janë të ndarë nga sistemet e shumta të qarjeve. Pseudostratifikimi është i shprehur mirë në harcburgite dhe ka drejtim VVP – JVL.

Produktet e Neogjenit - Produktet e neogjenit shtrihen në jugperëndim të basenit të Dukagjinit dhe zënë një sipërfaqe të madhe. Këto janë depozitime liqenore të ujërave të ëmbël të moshës së miocenit dhe pliocenit.

Sedimentet e miocenit janë konstatuar vetëm në veri dhe veriperëndim të Pejës. Këto sedimentet përbëhen nga mergelët e bandhë meostakade, tufe, ranoret mergelore, ranoret kokerrtrash me thjerza zhavorre.

Shtrirjet me të mëdha në rrafshine Dukagjinit e kanë produktet e ujërave të ëmbël të moshës pliocenike. Gjatë hulumtimet për qymyre në rrafshin e Dukagjinit kanë konstatuar trashësinë e madhe të këtyre sedimenteve deri në 1.00 m.

Produktet e Kuaternare - Në Rrafshin e Dukagjinit produktet e kuarternarit kanë shtrirje të madhe. Gjeneza dhe litologjia e këtyre depozitimeve është e ndryshme. Përveç krijimeve kontinentale janë të pranishëm edhe sedimentet liqenore. Sipas moshës janë konstatuar krijimet kuaternare të pliocenit dhe holocenit.

Sedimentet e pleistocenit janë: Liqenore, linoglaciale, glaciale, fluvoglaciale dhe ternasat lumone. Sedimentet liqenore më të përhapura janë në jug-lindje të Pejës, në fshatrat Dubovik dhe për gjatë rrugës Raushiq-Baran. Perfaqesohet nga ranoret angjilor me ngjyrë të kuqe dhe shtrihet në lartësi mbi detare 460 - 600m.

Sedimentet glaciale dhe lumë - glaciale janë konstatuar në Deçan, Loqan dhe Junik. Sedimentet fluvio-glaciale janë vërtet në rrjedhjen e sipërme të lumë bardhit të Deçanit ,të përfaqësuar nga morenet me përbërje të ndryshme petrologjike.


Terrasat lumore shtrihen në të dy anët lumenjve të Rrafshit të Dukagjinit me ç'rast janë konstatuar dy terrasa me mosha të ndryshme .Këto terrasa janë të tipit eroziv - akumulativ të mbuluara me ranor ,argjila dhe zhavorre me trashësi 1 – 5 m. Përbërja petrografike e këtyre sedimenteve është e ndryshme dhe varet nga përbërja gjeologjike e terrenit nëpër të cilin lumi kalon.

Depozitimet holocene paraqesin krijime kontinentale të përfaqësuar nga tipet të facieve të ndryshme gjenetike :morene, proluvione dhe aluvione. Morenet janë blloqe

shkëmbore me madhësi të ndryshme me diameter 1 – 10 m. Këto blloqe janë pjesë e shkëmbinjve kompakt si diabazet, graniteve, gëlqeroreve.

Proleviumet janë sedimentet të rrjedhave ujore të karakterit të vërshimeve. Mbulojnë sedimentet liqenore me gjatësi 4 – 5 km. Përfaqësohet nga copat e rrumbullakosura me diametër 5 – 20 cm. Deliviumet janë rezultat i shkatërrimit mekanik të shkëmbinjve dhe përbërja e tyre.

Aluvionet shtrihen përgjatë rjedhës së lumenjve Drini i bardhë Erenik, Lumbardhë i Pejës, Deçanit dhe Lloqanit.



Harta 3. Harta gjeologjike e lolacionit të planifikuar për shfrytëzim të rërës kuarcore

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Territori i komunës së Gjakovës ka biodiversitet mjaft të shumëllojshëm dhe të pasur. Ky diversitet i larmishëm i botës së gjallë është si rezultat i larmisë së ekosistemeve prezentë në këto hapësira. Në shtrirje horizontale dhe vertikale, diversiteti është i pasur duke filluar që nga ultësirat deri te lartësitë më të mëdha në malet e larta të territorit të hulumtuar. Llojet bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Gjakovës janë të përhapura në ekosistme të ndryshme, si në lumenjtë dhe përgjatë tyre (Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Llukaci dhe disa lumenj të vegjël por të rëndësishëm), në liqen (Liqeni i Radoniqit), në toka pjellore, livadhe dhe kullosa, male e bjeshkë të larta. Ky diversitet biologjik është pasojë e varietetit të gjeologjisë dhe pedologjisë në territor, duke filluar nga zonat luginare aluviale rreth lumenjve, fushëgropa e Gjakovës, kodrat dhe hapësirat kodrinore si ajo Has, Dushkaja etj., masivet malore në zonën e Qafës së Morinës dhe Qafës së Prushit, pjesët malore nën krahun e Pashtrikut, dhe deri te zonat malore të Bjeshkëve të Nemuna, që mund të quhen edhe Alpet Shqiptare në territorin e Kosovës. Duke pasur parasysh vlerat e trashëgimisë natyrore të këtij territori, rreth 5% e territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”) (apo rreth 2000 hektarë) shtrihen në territorin e Komunës së Gjakovës. Përveq kësaj, në këtë territor, ka edhe vlera të trashëgimisë natyrore të mbrojtura ligjrisht dhe të propozuara për mbrojtje me ligj (AKMM - IKMN 2008, 2010). Në total, ka 3 zona të mbrojtura me ligj (“Çabрати”, “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë” dhe “Shkukëza”), si dhe 28 zona të propozuara për mbrojtje ligjore që janë propozuar në vitin 2003. Këto zona janë me vlera të larta të biodiversitetit dhe sipërfaqe të pasurive të natyrës - fjala është për vlera të biodiversitetit.

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet e planifikuar për shfrytëzim të rërës kuarcore kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje.

3.10. Flora dhe Fauna

Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij lokaliteti të ngushtë janë ndryshimet intensive që kanë filluar si pasojë veprimtarisë së njeriut, kryesisht për zhvillim e aktivitetit minerar, më ç'rast edhe flora e fauna nuk janë shumë të zhvilluara, për shkak të aktivitetit minerar. Ndërsa në sipërfaqet e regionit më të gjerë ekzistojnë sipërfaqet e tokës pyjore. Pyjet e këtij regjioni kryesisht janë pyje të llojit gjethorë dhe përbëjnë një numër të madh të llojeve me rritje të ulta dhe mesatare, mal me rritje mesatar. Në bazë të shqyrtimeve vizuale në lokacionin ku do të shfrytëzohet rëra kuarcore kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, si kaçuba të qarrit, bungut, mal me rritje mesatare, etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në shkëmbinjtë gëlqeror, në këtë hapësirë gjenden edhe kaçë, murrizi, mana, manaferra, etj.

Pjesa e ngastrave në fjalë posaçërisht është e mbuluar me drunj me rritje mesatare dhe drunjë të ultë në formë të kaçubave, pjesët e ngastrave ku do të shfrytëzohet rëra kuarcore, nuk përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por as edhe si zone me vlera kullosore. Por kjo zonë për shkak të pozitës gjeografike dhe rezervave të gurit mund të kthehet në zonë industriale, për shfrytëzimin e gurit. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit më të gjerë, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në zonën më të largët nga lokacioni jetojnë gjitarët, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorra etj.

3.11. Dukshmëria

Shikuar nga pozita, ku parashihet të bëhet shfrytëzimi i rërës kuarcore në Zonën kadastrale Pjetërshan, dukshmëria është mjaft e lartë e posaçërisht kah ana juglindore e cila mund të mbërrijë 5-7 km. Ky rajon është i mbuluar nga mjegullat e hershme pranverore dhe vjeshtore edhe për shkak ta masivit malor në pjesën mbrapa parcelave në studim.

3.12. Ajri

Ndotja e ajrit në qytetin e Gjakovës dhe në rrethinë të tij është evidente, kjo argumentohet nga matjet që realizohen nga institucionet kompetente.

Ndotja e ajrit vjen si pasojë e shkarkimeve industriale, nga aktivitete urbane, ku veçohet trafiku i automjeteve (të vjetruara) të shumta në komunikacion të dendur, sidomos nga rrugët magjistrale, ngrohja e ekonomive familjare me lënde djegëse thëngjill dhe dru gjatë stinës së dimrit, etj.

Ndërsa në lokalitetin e planifikuar për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore dhe nga vet konfiguracioni i terrenit mund të konkludojmë se nuk ka ndotje të ajrit në këtë lokalitet.

3.13. Uji

Siç e kemi cek edhe më parë, në këtë rajon nuk kemi hasur në ndonjë rrjedhë ujore të tipit të lumenjve apo ndonjë liqeni. Ato pak që krijohen mund të jenë kryesisht nga reshjet atmosferike kryesisht në kohë të dimrit. Në përgjithësi ujërat në lokacione të tilla të përafërta për skaj rrugës mund të ndoten edhe nga trafiku që zhvillohet për gjatë rrugës po ashtu edhe nga shpërlarja e tokës nga të reshurat atmosferike.

3.14. Zhurma

Në lokacionin e analizuar/në studim nuk kemi matje të zhurmës. Zhurma që krijohet në lokacionin ku do të zhvillohet aktiviteti minerar, me infrastrukture përcjellëse, shkaktohet nga eksploatimi i rërës kuarcore, transportimi i inerteve deri tek thërrmoja. Po ashtu zhurma mund të vijë edhe nga makinat transportuese të fraksioneve të rërës. Mund të konstatojmë se me respektimin e standardeve dhe normave të lejuara lidhur me aktivitetin minerar, nuk gjeneron ndonjë zhurmë të përhershme që do të ndikonte në psikikën dhe koncentrimin njeriut në punë dhe rrethinë.

3.15. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleks i aktivitetit të shfrytëzimit të gurit gëlqeror – mjedis. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë

parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Andaj pritët nga kompania që të punoj në harmoni me natyrën dhe të mos ndikoj në aspekt negativ në pamjen vizuale të zonës ku bëhen planifikime për shfrytëzimin e rërës kuarcore.

4. 0. Procesi teknologjik i shfrytëzimit të rërës kuarcore

4.1. Përshkrimi i përgjithshëm

Shfrytëzimi dhe përpunimi i rërës kuarcore realizohet sipas projektit kryesor të xehetarisë, ku janë përcaktuar parametrat tekniko-teknologjikë për hapjen dhe operimin e karrierës, si dhe procesi i seperimit dhe pastrimit të rërës për përgatitje tregu.

4.2. Parametrat e karrierës

- **Lartësia e shkallëve:** ~10 m
- **Gjerësia e sheshit të shkallës:** 10-15 m
- **Pjerrtësia punuese e shkallës:** 70°
- **Numri i shkallëve:** 3

Hapja e karrierës fillon nga kuota fillestare dhe zhvillohet në faza të njëpasnjëshme, duke u zbatuar masat për stabilitetin e skarpeve dhe sigurinë në punë.

4.3. Procesi i shfrytëzimit

1. **Heqja e mbulueseve** (humusi dhe sterili) dhe deponimi i tyre në deponitë e projektuara, për t'u përdorur më vonë në rehabilitim.
2. **Gërmimi dhe ngarkimi i rërës kuarcore** me eskavatorë ose lopata ngarkuese.
3. **Transporti i lëndës së parë** me kamionë drejt fortinave (magazinave të përkohshme).

4.4. Procesi i përpunimit teknologjik (seperimi dhe larja)

Pajisjet kryesore të impiantit të seperacionit:

- Bunker furnizues
- Dozator i shiritit transportues

- Shirita transportues
- Sita vibruese (klasifikator)
- Impiant spiral për larje me ujë
- Shirita transportues për fraksione të ndara (0-1 mm, 1-2 mm, +2 mm)

4.5. Faza të procesit teknologjik:

a. Shkarkimi në bunker

- Rëra kuarcore shkarkohet nga kamionët në bunker përmes automjeteve vetëshkarkuese.

b. Dozimi

- Nga bunker, përmes dozatorit, rëra transferohet në shiritin transportues.

c. Sitja dhe larja primare

- Rëra kalon në sitën vibruese, ku ndahet sipas madhësisë dhe spërkatet me ujë për heqjen e argjilës dhe pluhurit.

d. Larja sekondare (spirale)

- Fraksioni 0-2 mm kalon në impiantin spiral të larjes, ku realizohet larja e plotë dhe ndarja e mbetjeve të mbetura argjilore.

e. Bluarja (nëse kërkohet)

- Fraksioni më i imët (0-1 mm) bluhet në mullirin përkatës për të arritur granulimin e kërkuar nga blerësit.

f. Transporti final dhe depozitimi

- Fraksionet e ndara (0-1 mm, 1-2 mm, +2 mm) transportohen me shirita të dedikuar drejt zonave të depozitimit për shitje ose përdorim industrial.

4.5. Sistemi i pastrimit dhe reciklimit të ujit

- Përbëhet nga tuba FE 510 me gryka tunxhi për spërkatje dhe valvola me top për rregullimin e sasisë së ujit.
- Sistemi siguron larje efikase dhe, nëse aplikohet reciklimi i ujit, ul konsumet operative.

4.6. Mekanizimi dhe infrastruktura ndihmëse

- Makinat dhe mekanizmi: eskavatorë, lopata ngarkuese, kamionë transportues.
- Rezervuar uji për procesin e larjes.
- Ndërtesa për personel dhe magazinim pjesësh rezervë.

4.7. Karakteristikat e procesit teknologjik

- Proces i mbyllur teknologjik: i gjithë materiali që hyn në proces del si produkt final pa humbje.
- Përshtatje fleksibile për kërkesat e tregut për granulimet e ndryshme.
- Efikasitet i lartë i ndarjes dhe larjes për shkak të pajimeve të specializuara.

4.8. Masat e sigurisë teknike dhe ambientale

1. Stabilizimi dhe monitorimi i skarpeve.
2. Deponimi korrekt i sterilëve dhe mbulueseve për rehabilitim të ardhshëm.
3. Kujdes në menaxhimin e ujërave të ndotura përmes filtrimit dhe dekantimit.
4. Trajnimi i stafit për përdorimin e pajimeve dhe respektimin e standardeve të sigurisë.

5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve teknologjike që kryen kompania „Art Minerals” LLC, në zonë kadastrale Pjetërshan, komuna Gjakovës. Projekti i shfrytëzimit të rërës kuarcore tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize më gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Në kuadër të procesit të marrjes së pëlqimit mjedisor po hartohet ky raport për të paraqitur disa nga fazat e mundshme të efekteve negative që paraqiten në mjedisin jetësor dhe atë gjatë fazës së funksionimit të tij, po ashtu dhe pas përfundimit të procesit në mënyrë që të paraqiten të dhëna për ndikimet eventuale dhe të mundshme që vijnë nga aktiviteti në fjalë.

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet për fazën e zhvillimit të aktiviteteve në kompaninë “Art Minerals” LLC, gjithashtu duhet parapare edhe ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit të rërës kuarcore.

5.1 Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e shfrytëzimit të rërës kuarcore, ndikim negativ në mjedis kryesisht shprehet në ajër, zhurmë dhe peisazh. Ndikimet tjera pak a shumë janë më të pa

rëndësishme në krahasim me këto ndikime. Në zonën e shtrirjes së trupit mineral me objektet tjera përcjellëse, deri te ndotja e ajrit vjen për shkak të punëve dhe aktivitetit në minierë, sidomos: Gjatë procesit të mihjes, gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit, gjatë procesit të transportit dhe përpunimit dhe klasifikimit, etj.

Ndotësit janë kryesisht grimcat e mëdha të pluhurit të cilat lirohen gjatë aktiviteteve të cilat zhvillohen për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore dhe atë gjatë mihjes, ngarkimit dhe transportit gjerë të thërmuesja, pluhurat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, kurse pluhurat me përbërje granulometrike të imta dhe përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lënda minerale, i bartë ajri për shkak të relievit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca ma të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit. Gjatë realizimit të procesit teknologjik për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore, ndikime negative në ajër ndodhin nga:

- Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e mihjes/shfrytëzimit të rërës kuarcore.
- Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjithë shiritat transportues si dhe në sitat vibruese.
- Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërmuar/klasifikuar.
- Pluhurat të cilët lirohen gjatë ngarkimit dhe transportimit të fraksioneve me automjetet transportuese.
- Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të minierës dhe thërmueses me seperacion.
- Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e ngarkimit dhe transportit.

Gjithashtu gjatë aktivitetet e nxjerrjes dhe transportit të rërës dhe zhavorrit çojnë në emisione të gazrave serë, si dyoksidi i karbonit (CO_2) dhe metani (CH_4). Këto gazra kontribuojnë në ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale. Ndotësit e ajrit si pjesëza të vogla (PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$) dhe ndotës të tjerë, si oksidet e azotit (NO_x) dhe dyoksidi i squfurit (SO_2), shkaktohen nga aktivitetet e nxjerrjes dhe transportit.

5.2. Ndikimet në tokë

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa shterpë (sterili) e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës. Trashësia e sterilit sillet gjerë 50 cm, depozitimi i tij duhet të bëhet në një anë ku nuk pengon proceset minerare.

Varësisht nga fronti i punëve në minierë, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç'rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të boshatisura nga proceset e shfrytëzimit të rërës kuarcore.

Si ndikime negative tjera në tokë gjatë realizimit të proceseve teknologjike për mihjen sipërfaqësore për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore mund të identifikohen:

- Humbja e një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës brenda kontureve prej 20000 m².
- Nxjerrja e materialeve dhe largimi i vegjetacionit natyror çojnë në rritjen e erozioneve, duke e bërë tokën më të ndjeshme ndaj erozionit.
- Procesi i nxjerrjes ndikon në habitatet natyrore, duke shkatërruar vendet e jetesës për shumë specie.
- Reduktimi i biodiversitetit dhe rreziku për speciet që varen nga këto habitatet.
- Shkaktohen ndryshime në strukturën fizike të tokës, si kompresimi ose thyerja e shtresave. Kjo ndikon në aftësinë e tokës për të mbajtur ujë dhe për të mbështetur bimët
- Deponimi i fraksioneve të prodhuara nga seperacioni dhe mbeturinat nga këto prodhime.
- Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese.
- Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese.
- Mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
- Pluhuri i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër).
- Ngjeshja e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

- Mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të proceseve teknologjike për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore mund të shkaktohen:

Nga germimi dhe largimi i materialeve rrisin erozionin e tokës.

Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.

Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit shpesh ul nivelin e vegjetacionit,

Nga vajrat dhe lubrifikantët e ndryshëm që derdhën nga pajimet dhe stabilimentet prodhuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.

Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese. Nga ujërat e zeza dhe pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku planifikohet të bëhet mihja sipërfaqësore për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore me objektet përcjellëse, gjithnjë do të merrë pamjen e një vendi industrial. Gjatë fazës së shfrytëzimit normalisht, peizazhi pëson një degradim me hapjen e gropave dhe prishjen e një konturi natyror, por me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do të kthehet pamja në harmoni me gjendjen të përafërt me gjendjen e rrethit. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensimin të shfrytëzimit të pasurive/resurseve natyrore.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve teknologjike të cilat zhvillohen në mihjen sipërfaqësore për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore dhe në gjatësinë kohore të operimit germimit dhe largimit të materialeve shkatërron habitatet natyrore të shumë specie.

Kjo çon në humbjen e vendeve të jetesës për bimë dhe kafshë, duke rritur rrezikun e zhdukjes së disa llojeve. Por e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve minerare dhe prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet/zhvendoset në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Zhvillimi i veprimtarisë shfrytëzuese të rërës kuarcore nga kompania „Art Minerals” LLC për këtë rajon ka një rënësi të veçantë për popullatën e këtij regjioni sepse do të bëjë punësimin e një numri të punëtorëve. Nga faktet e lartë cekura mund të konkludojmë se në aspektin social dhe ekonomik kompania „Art Minerals” LLC që veprimtarinë e vet e ka shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore kudo të ketë ndikime pozitive në popullatë.

5.7. Zhurma

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve për shfrytëzimin dhe përpunimit të rërës kuarcore, kryesisht nga makinat gjatë procesit të mihjës, ngarkimit, transportit, dhe nga proceset teknologjike tjera të rërës kuarcore.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Duke pasur parasysh largësinë e vendbanimeve zhurma për zonën e banuar do të jetë plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës rrallë punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db–niveli për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste aksidenteve mjedisore

Bazuar në aktivitetin e eksploatimit dhe përpunimit të rërës kuacore nga kompania „Art Minerals” LLC, në zonën kadastrale Pjetërshan komuna e Gjakovës mund të ketë ndonjë incident me karakter lokal, i cili mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

Gjatë mihjes së zhavorrit

Gjatë punëve në etazhet punuese.

Gjatë procesit të thërrmimit dhe seperimit të rërës kuacore

Gjatë proceseve tjera teknologjike në shfrytëzimin.

Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia plasjes së gypave hidraulik, mundësia e ndezjes). Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të fraksioneve të prodhuara.

6. MARJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

6.1. Masat e marra për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuacore të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Spërkatja me ujë mbi sipërfaqet e nxjerrjes dhe transportit për të ulur pluhurin.
- Përdorimi i pajisjeve dhe teknologjive që reduktojnë emisionet gjatë nxjerrjes dhe transportit.
- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve për seperimin e rërës kuacore e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.
- Duhet të bëhet vendosja dhe mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen.
- Të gjitha sipërfaqet operationale dhe rrugët (pjesët e pa asfaltuara) ku do të bëhet transportimi i rërës kuacore duhet vazhdimisht të stërpiken me ujë.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda punuese me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate.
- Mbjellja e drujve gjethembajtës rreth zonave të nxjerrjes për të filtruar ajrin dhe për të ulur pluhurin.
- Duhet rregullisht të jetë në dispozicion cisterna me ujë rezervë.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, në kohëra të thata edhe të spërkaten me ujë

6.2. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytëzimin dhe përpunimin e rërës kuarcore duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.
- Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rikultivim biologjik.
- Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e mundur.
- Varësisht nga fronti i punëve në minierë, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç' rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.
- Të ndërpritet puna në kohëra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin ku shfrytëzohet dhe përpunohet rëra kuarcore për shkak të avarive në makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe

duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.


- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në minierë duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontejnerë të posaçëm të cilët do të i zbrazin kompanitë që kanë veprimtarin e grumbullimit të tyre dhe të i dërgojnë në deponin rajonale.
- Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Depoja ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thuret me mur statik si dhe pllatoja (dysHEMEJA) të betonohet.
- Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes së orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to.

6.3. Masat për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e mihjes sipërfaqësore nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përfaqë sipërfaqes së mihjes sipërfaqësore. Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e mihjes sipërfaqësore nga vërshimet gjatë të reshurave atmosferike, dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e mihjes sipërfaqësore gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen pusët sedimentuese për sedimentimin e materieve të ngurta dhe separatori për pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale të mihjes sipërfaqësore, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e pastra të lëshohen në recipient. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe separatori. Në mihjen sipërfaqësore gjithmonë duhet të ketë në disponim absorbues të vajrave dhe derivateve. Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen në recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga pronari

apo kompanitë e licencuara. Gropa septike duhet të ndërtohet në at mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe mostrim të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient.

Ne vijim po e paraqesim shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura.



Rekomandohet që të ndërtohet një rezervar me qëllim të mbajtjes së ujërave të trajtuara, uji i trajtuar (pastruar) do të rikthehet në procesin teknologjik, kështu që do të mbyllet cikli i trajtimit dhe furnizimit me ujë industrial, dhe do të parandalohet shkarkimi i ujërave.

Do të ekzistojnë dy mundësi të shkarkimit të ujërave të trajtuara njëra drejt për drejt nga separatori në recipient, tjetra mundësi prej separatorit në rezervuar, prej nga do të shkarkohet në recipient nëse nuk nevojitet për procesin teknologjik, që shihet edhe nga shema teknologjike e trajtimit të ujërave të ndotura. Ujërat nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse vlerat janë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në

fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimorë dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimorë kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave shfrytëzuese nga erozioni dhe masave mbi mbrojtjen e ajrit. Duhet të ketë kujdes që të mos prej sipërfaqe të mëdha të drujve, të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merren masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës shfrytëzuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, etj.

6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Kryerja e një analize të detajuar të rreziqeve për të identifikuar faktorët që mund të shkaktojnë prishje të pasurive.
- Ofrimi i trajnimeve për punonjësit mbi procedurat e sigurisë dhe përdorimin e pajisjeve për të minimizuar rreziqet.
- Duhet të kenë në dosponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet e tërë fusha shfrytëzuese të thuret me tel gjembor.
- Të merrren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7. Monitorimi

Ndikimet direkte nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime

janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e emisionit) gjatë punës maksimale të pajimeve, matja duhet bërë te shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, duhet bërë krahasimin e rezultateve me rezultatet e më hershme dhe vlerat e caktuara me ligjet në fuqi, rezultatet të raportohen në Ministri të Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës sipas kërkesës së tyre.

8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Investitori është i obliguar që të bëjë monitorimin e përhershëm të ndikimeve negative në mjedis e posaçërisht monitorimin e tokës, ajrit dhe zhurmës. Këto ndikime mund të jenë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave mbrojtëse dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e emisioneve) dhe zhurmës gjatë punës maksimale të pajimeve, matja duhet bërë te shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute të akredituara për llojin e analizës. Të bëhet kontrollimi i përhershëm i seperatorve si dhe i gropës septike, dhe zbrazja e tyre të bahet me kohë. Kontejnerët e mbeturinave të zbrazën rregullisht. Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së projektit, e kjo varet nga pronari se sa do të vazhdoj me këtë projekt. Karriera e hapur pas përfundimit të shfrytëzimit përfundimtar do të krijohet një shesh në të cilën është e domosdoshme të bëhet rikultivimi i etazheve në mardhënie me ambientin rrethues. Gjendja e terrenit mundëson që sipërfaqja e karrierës të rikultivohet me bimë të cilat i përshtatën kushteve mjedisore-klimatike që përmirëson peizazhin, pamjen vizuale, pengon procesin e erozionit dhe arrin efektet e dëshirueshme mjedisore për brezat e ardhshëm. Pas përfundimit të jetë gjatësisë së projektit e kjo varret nga rezervat e rërës kuarcore në mihjen sipërfaqësore. Pas këtij afati pajimet e duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale. Rikultivimi si proces mjedisor realizohet në marrëdhënie në tri faza.

- Faza teknike
- Faza agro-teknike dhe
- Faza biologjike

9.1. Faza e teknike e rikultivimit

Faza e teknike e rikultivimit përfshin aktivitetet e përgatitjes së karrierës me qëllim të rregullimit të terrenit, gjeësisht mbushjes, shtrirjes së sterilit në sipërfaqen e karrierës e cila duhet të jetë e përshtatshme për shtrirjen e humusit.

9.2 Faza e rikultivimit agro-teknik

Masat agro-teknike të cilat duhet të kryhen janë:

Shpërndarja e pjesës humusore me trashësi adekuate 50 cm, në tërë sipërfaqen e përgatitur për rikultivim. Me qëllim të rritjes së stabiliteti dhe përfitimit të kompaktësisë duhet të bëhet aktiviteti i ngjeshjes. Pas kryerjes së këtij operacioni duhet bërë hapja e kanaleve, apo birave për mbjelljen e fidanëve. Gjerësia dhe thellësia e birave duhet të jetë e gjerë sa është shtrirja e lirë e sistemit rrënjësor të bimës. Në gropat e hapura duhet bërë plehërimin me qëllim që fidanët në procesin fillestar të vegjetacionit të kenë materie ushqyese të mjaftueshme për zhvillim. Mbjellja e fidanëve duhet bërë në sezonin e vjeshtës kur sasia e lagështisë është më e madhe me qëllim që bima të ketë fillim të suksesshëm të vegjetacionit në stinën e pranverës.

Investitori obligohet që fidanët të cilat mbillen të kenë certifikatën shëndetësore për gjendjen e tyre nga prodhuesi i licencuar. Procesi i mbjelljes duhet bërë duke hequr pjesët e rrënjëve dhe pjesët tjera të dëmtuara. Para mbjelljes së fidanëve, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion të freskët prej argjile duke bërë një kombinim i cili shërben si ushqim fillestar për bimën. Përgatitja e kushteve në këtë mënyrë, bima është e gatshme të mbillet.

Dimensionet e gropave për mbjelljen e bimës duhet të jetë 40 x 40 cm

Distanca e ndërmjet bimëve në rendë duhet të jetë 2 m.

Distanca në mes rendeve duhet të jetë 3 m.

Drejtimi i mbjelljes së rendeve duhet të jetë VJ-PL

$$Nrf = S / a \times b$$

Nrf- numri i fidanëve

S-Sipërfaqja (m²)


a-distanca e fidanëve (m)

b- distanca e filaneve në mes rendeve (m)

9.3 Faza e rekultivimit biologjikë

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave ekologjike dhe përshtatshmërisë së ambientit bimët të cilat i rekomandohet investitorit të mbillet është Bredhi i zi, është bimë halore gjethembajtëse që i përshtatet kushteve klimatike të rajonit, në këtë lokacion. Mbjellja e këtij druri do të përmirësoj pamjen vizuale, peizazhin, freskon ambientin, do të ketë pamje me të bukur, dhe shton sipërfaqen e pyllëzuar që është e mangët në këtë zonë. Bredhi i zi është bimë rezistuese ndaj ndryshimeve klimatike temperaturave ekstreme dhe është rezistues ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar këto bimë, duhet të bëhet konsultimi me autoritetet komunale dhe te Ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë. Investitorit i rekomandohet që pas mbjelljes së fidanëve të përkujdeset për rritjen e fidanëve të mbjellura.

Përgatitja dhe mbjellja e fidaneve shihet ne figurat e më poshtme.



10. Kontrolli i emisioneve pas shfrytëzimit

Me përfundimin e aktivitetit mineral në minierë për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore dhe aktiviteteve tjera teknologjike, respektivisht pas përfundimit të jetës së minierës dhe rehabilitimit të ngastrave për qëllime tjera, nuk është e nevojshme dhe nuk parashihet monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës apo ndikimet tjera në mjedis për shkak të shfrytëzimit përfundimtarë të minierës. Kompania shfrytëzuese, ka për detyrë të bëj monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar për një kohë të caktuar.

11.0 PËRFUNDIM

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinionëve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludojmë si në vijim:

Aktiviteti i shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore është parapar për tu zhvilluar në zonën kadastrale Pjetërshan në komunën e Gjakovës me pronar z. Ilir Dedaj dhe është në interes;

- Të vet investitorit për të zhvilluar biznesin e tij. Në interes të komunës për rritjen e kapaciteteve prodhuese të rërës, poashtu do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë.
- Në interes të Kosovës e veçanërisht komunitetit lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me të menaxhuar, mundësi punësimi, dhe ruajtje e mjedisit.

Ndikimi në tokë është i madh, ndërsa ndikimi në ajër, zhurmë dhe ujë mund të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohet në fund të çdo viti kalendarik dhe sipas kërkesës së MMPHI-së. Pas punimit të këtij raporti të VNM-së, mund të konkludohet se aktiviteti i shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatohet se ato mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara. Gjithashtu, është paraparë që paralel me shfrytëzimin e gurit gëlqeror, të bëhet edhe rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara aty ku lejojnë mundësit e operacioneve teknologjike të shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues (MMPHI-së) dhënien e mendimit për Pëlqimi Mjedisor sipas kërkesës së pronarit të biznesit “Art Minerals” LLC, z. Ilir Dedaj, për aktivitetin e shfrytëzimit dhe seperimit të rërës kuarcore në zonën kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës.

12. LITERATURA

1. Draft Plani zhvillimor komunalë Gjakovë 2021-2029
2. Projekt harta zonale e komunës së Gjakovës 2022-20304
3. Agjensia e statistikave të Kosovës
4. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
5. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
6. MMPH-AKMM -IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
7. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design Prishtinë.
8. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
9. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
10. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,
11. mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.

Shtojcë

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Te dhënat për biznesin,
- Certifikata e pronës,
- Kopja e planit,
- Pëlqimi i komunës,
- Situacioni i terenit
- Deshmia për vlerën financiare investuese te projektit

PËRSHKRIMI I VLERËS INVESTIVE

PËR PROJEKTIN ME TITULL: Shfrytëzim dhe seperim i rërës kuarcore

ZONA KADASTRALE Pjetërshan KOMUNA Gjakovës

PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR “ART MINERALS” LLC

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Zona e shfrytëzimit Punë përgatitore, zbulim i sheshit të punës, hapja e rrugës dhe vendosja e therrmojsës	
2.	Therrmojsa dhe Seperator i ndarjes se materialit	
3.	Kamion (2 copë)	
4.	Ekskavatorë	
5.	Ngarkues/Ultë	
Shuma totali investive:		

Aplikuesi i projektit:

z. Ilir Dedaj, drejtor i kompanisë

_____ **v.v.**

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës			
Data e aplikimit			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	Shfrytëzim dhe seperim i rërës kuarcore		
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	€		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,		Po	Jo
	1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-së (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).	X	
	2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore	X	
	3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit	X	
	4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).	X	
	5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref	X	
	6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar	X	
	7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor		
	8. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;	X	
	9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit	X	
	10. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive : Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve		
	11. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.	X	
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	z. Ilir Dedaj		
Kompania	“Art Minerals” LLC		
Adresa e Kompanisë	Rr. Skenderbeu, Gjakovë		
Tel, fax, E-maili	044 115 382 048 104 797		